



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ .2021

Lënda: Jepet informacioni i kërkuar.

I.SH.SH

TIRANË

ZNJ. A.B

E nderuar znj. Brahaj,

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë tuaj, në cilësinë e kërkuarit keni paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përputhje me nenin 11 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e Informimit”, dy kërkesa të njëjta për dhënie informacioni, regjistruar me nr. rendor 274, datë 20.01.2021, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktet nr. 252 Prot., dhe nr. 252/1 Prot., ju informojmë se:

Duke mbajtur në konsideratë ligjin për të dhënat personale, bashkëlidhur kësaj shkresë po ju dërgojmë informacionin e kërkuar (6 faqe). Në informacionin bashkëlidhur nuk gjenden të dhënat për z. Bashkim Dedja, pasi Gjykata Kushtetuese nuk është në juridiksionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu, nuk janë subjekt i veprimtarisë së KLGJ-së, ish-gjyqtarët znj. Alma Brati dhe z. Astrit Faqolli, pasi janë shkarkuar me vendim të formës së prerë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Sjellim në vëmendjen tuaj se informacioni në përputhje me vendimin nr. 114 datë 09.07.2019, të KLGJ-së, për aq sa ligji për të dhënat personale lejon, është publikuar në faqen zyrtare të internetit www.klgj.al në rubrikën <http://www.klgj.al/programi-i-transparences/>.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,